



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V\_959\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1619\_09\_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **03.10.2017**.

në seancën e mbajtur më datë **29.03.2018**, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.B., nga Prishtina, me shifër të konsumatorit **DPZ - 9032345** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1619\_09\_17 i datës 08.09.2017.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Faturimi i muajit 06/2014 dhe 05/2015 është faturim me vlerësim pasi nuk ka ofruar qasje dhe se në momentin kur është vërejtur se konsumatori nuk ka shpenzim në tarifën e lartë atëherë është bërë korrigjimi i kWh dhe shpërndarja e tyre 06/2014, 07/2014 dhe 05/2015 dhe 06/2015. Ndërsa fatura e muajit 07/2014 dhe 06/2015 janë fatura me matje. Gjithashtu qendra e kalibrimit ka konstatuar se njehsori është brenda kufijve të lejuar. Gjithashtu kur DMK ka bërë krahasimin e shpenzimeve në periudha të ndryshme ka konsideruar se shpenzimi duhet të jetë e njëjtë, ka gabuar ngase shpenzimi tregon të kundërtën.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE\_V\_1619\_09\_17, në lidhje me shifrën DPZ - 9032345 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se faturimi i muajit 06/2015, 06/2014 dhe 05/2015 është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet te tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë



elektrike konsumatori ka dallim të madh të shpenzimit mes periudhave kontestues dhe periudhave tjera kur faturimi ka qenë i rregullt dhe korrekt.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalin inspektimit të njehsorit elektrik nr.0617125 të datës 07.07.2015 dhe rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe se gjatë analizimit të gjendjes së shpenzimit është vërejtur se kemi mospërputhje të shpenzimeve të njehsorit elektrik nr.4694345 në mes të gjendjes së shpenzimit të evidentuar në procesverbal dhe atë të evidentuar në rrjedhën e shpenzimit të energjisë aktive.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO, se faturimi i muajve 06/2014, 05/2015, 07/2014 dhe 06/2015 është faturim real dhe në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, kjo nuk qëndron ngase sipas rrjedhës së energjisë elektrike vërehet se njehsori elektrik nr.4694345 te konsumatori me shifër DPZ – 90032345 është vendosur në muajin 03/2010, dhe nga ajo periudhë e deri më 05/2013 ka regjistruar energji elektrike në rregull në të dy tarifat, pas kësaj nga kjo periudhë e deri në periudhën e ndërrimit të atij njehsori 07/2015 ka regjistruar energji elektrike vetëm në tarifën e ulët (konsumatori gjatë kësaj periudhe është faturuar si konsumator i grupit tarifor 6 apo 4/01), përveç dy muajve 06/2014 dhe 05/2015 kur konsumatori është faturuar pa matje/paushall dhe ka regjistruar energji elektrike në të dy tarifat. Duhet theksuar se KEDS-i gjatë kësaj periudhe nuk ka dhënë sqarime se pse njehsori elektrik nr.4694345 nuk ka bërë regjistrim të shpenzimeve në të dy tarifat gjatë periudhës 05/2013 e deri më 07/2015, madje as në procesverbalin e inspektimit nr.0617125 të datës 07.07.2015 nuk është dhënë se pse njehsori elektrik nuk është duke regjistruar energji elektrik në të dy tarifat. Pra KESCO konsumatorin me shifër DPZ – 90032345 për periudhat 06/2014 dhe 05/2015 është dashur ta faturojë sipas shpenzimeve të energjisë elektrike dhe jo me vlerësim.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se DMK gjatë krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike të ka theksuar se shpenzimi gjithmonë duhet të jetë i njëjtë, Bordi i ZRRE-së thekson sipas rrjedhës së energjisë elektrike të konsumatorit mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike te ky konsumator para dhe pas periudhës kontestuese nuk ndryshon shumë, por që ka ndryshim të madh në krahasim me shpenzimin mujor të muajit kontestues 06/2015 me shpenzim mujore prej 2640 kWh. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para periudhës kontestuese 03/2010 e deri më 05/2015 është **554.35 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën pas periudhës kontestuese 07/2015 deri më **482.42 kWh/muaj**. Gjithashtu është bërë analizimi i shpenzimeve të energjisë elektrike sipas sezonave dhe ka vërejtur se nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike mes sezonave para dhe pas periudhës kontestuese. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për sezonën verore për periudhën para kontestit prej 04/2014 deri më 09/2014 është **467 kWh/muaj**, ndërsa për periudhën pas kontestit mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike periudhës 04/2016 deri më 09/2016 është **502 kWh/muaj**. Ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për sezonën dimërore për periudhën para kontestit prej periudhës 10/2014 deri më 03/2015 është **559 kWh/muaj**, ndërsa për periudhën pas kontestit mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike periudhës 10/2016 deri më 03/2017 është **465 kWh/muaj**.

Sa i përket pikës së kundërshtimit lidhur me atë se faturimi periudhave 07/2014 dhe 06/2015 është faturim me lexim dhe i saktë, Bordi i ZRRE gjatë analizimit të shkresave të lëndës konstaton se shpenzimi i faturuar për një muaj 06/2015 prej **2,640 kWh** ose llogaritur në vlerë financiare prej **202.86€**, nuk përputhet me gjendjen reale të shpenzimit të energjisë elektrike që bënë konsumatori, pasi që shpenzimi i energjisë elektrike para dhe pas kësaj periudhës kontestuese (periudha 01/2016) është i pothuajse i njëjtë. Andaj nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive një faturim i



tillë është i pasaktë dhe si i tillë duhet të korrigohet në përputhje me shpenzimin që bënë konsumatori para dhe pas periudhës kontestuese.

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë ZRRE konstaton se fatura e muajit 06/2015 në vlerë financiare prej 202.86€ për shkak të faturimit të pabazë duhet të shkarkohet dhe për këtë muaj KESCO duhet të ngarkoi konsumatorin me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 06/2016 (TL=255kWh dhe TU=207 kWh), ndërsa për faturën e muajit 06/2014 KESCO duhet ta shkarkoj dhe të faturohet si konsumator i grupit tarifor 6 me shpenzim prej TL=0 kWh dhe TU=482 kWh, si dhe për faturën e muajit 05/2015 duhet të shkarkoj dhe të faturohet si konsumator i grupit tarifor 6 me shpenzim prej TL=0 kWh dhe TU=465 kWh.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Boardi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S. B. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së